

VENDIM
Nr.125, datë 23.2.2011

PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË RRUGORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e “Strategjisë kombëtare të sigurisë rrugore 2011-2020” dhe “Planit të veprimit për sigurinë rrugore 2011-2015”, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në zbatim të objektivave të Qeverisë për përmirësimin e sigurisë rrugore dhe uljen e numrit të aksidenteve rrugore.

2. Ngarkohen ministritë të hartojnë programet e punës për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit, mbështetur në buxhetin e tyre.

3. Çdo gjashtë muaj të dërgohet informacion në sekretarinë teknike të Komitetit Ndërmnistror të Sigurisë Rrugore (KNSRR) për zbatimin e planit të veprimit të periudhës respektive.

4. Ngarkohen ministrat anëtarë të Komitetit Ndërmnistror të Sigurisë Rrugore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha